

Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria – Vlada – Government  
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde – Ministry of Justice  
Departamenti për Profesione të Lira – Departmant Slobodnih Profesija – Department of  
Freelance Professions

Komisioni Disiplinor/Diciplinska Komisija/ The Disciplinary Comitee

Nr.10//2020

**KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUES PRIVAT**, në përbërje të Xhemil Elshani kryesues, Diellza Hoxha dhe Rushit Hoxha anëtarë, në çështjen disiplinore ndaj P si organ përmbarues i emëruar nga Ministria e Drejtësisë për Territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, i dyshuar për shkelje disiplinore nga neni 367 par.1 të LPP-së, dhe dispozitave të Udhëzimit Administrativ MD.nr.09/2014, pas mbajtjes së seancës dëgjimore publike në të cilën prezentuan përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë për profesionet e lira- Divizioni për Noteri dhe Përmbarues privat Fadilete Hoxha, në cilësi të iniciuesit të procedurës disiplinore, të palës ankuese a Prishtina, dhe të autorizuarit të saj rezencën e as mbajtjes së seancës për këshillim dhe votim të mbajtur me dt. 25.09.2020, muar këtë:

## V E N D I M

**I.REFUZOHET** Raporti përfundimtarë i Ministrisë së Drejtësisë –Departamenti për profesione të lira – Divizioni për Noterin dhe Përmbaruesit Privati DPL 10/2020 të dt. 21.04.2020, dhe ankesa e palës ankuese : .04.2020, si e pa bazuar.

**II.Organi Përmbarues- ] nuk është përgjegjës për shkelje disiplinore të pretenduar nga neni 367 par. 1 të LPP-së, sipas lëndës përmbarimore P.nr. 1346/18.**

## A r s y e t i m

Pranë Ministrisë së Drejtësisë në Prishtinë, për fillimin e procedurës disiplinore ndaj organ përmbarues i emëruar nga Ministria e Drejtësisë për

territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, për shkeljen disiplinore nga neni 367 par. 1 të LPP-së, me dt. 21.04.2020, bazuar në ankesën e ankueses : [redacted], e cila ka parashtruar me dt. 17.04.2020, ka kërkuar iniciimin e procedurës disiplinore, sepse përmbartuesi privat në këtë rast me rastin e ndërmarrjes së veprimeve procedurale përmbartimore sipas lëndës P.nr. 1346/18, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e ligjit të procedurës përmbartimore, me çrast ka tejkaluar autorizimet e besuara me ligjin mbi përmbartimin të parapara me nenin 367 par. 1 si dhe gjatë kryerjes së veprimeve në kuadër të aktivitetit të tij përmbartuesi privat nuk i është përmbartur ligjit të paraparë me nenin e lartpërmendur, dhe kërkuara nga komisioni disiplinor të shqiptohet masa disiplinore dhe ate shkarkim nga detyra.

Ministria e Drejtësisë – Departamenti për profesionet e lira – Divizioni për Noteri dhe Përmbartuesit Privat me dt. 21.04.2020 ja ka paraqitur komisionit disiplinor propozimin për fillimin e procedurës disiplinore ndaj [redacted], si organ përmbartues i emëruar nga Ministria e Drejtësisë për territorin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, i dyshuar për shkelje disiplinore të paraparë nga neni 367 par. 1 të LPP-së, sepse i njejtë me rastin e ndërmarrjes së veprimeve përmbartimore sipas lëndës së përmbartimit P.nr. 1346/18 ka shkelur ligjin e përmbartimit, për çka në këtë mënyrë ka tejkaluar autorizimet e tija ligjore, dhe i ka propozuar-rekomanduar zhvillimin e procedurës disiplinore.

Në kuptim të dispozitave të nenit 4 dhe 7 të Udhëzimit Administrativ MD.nr.09/2014 komisioni disiplinor ka caktuar seancën dëgjimore me dt. 25.09.2020 në ambientet- zyrat e Ministrisë së Drejtësisë, në të cilën seancë kanë marrë pjesë të gjitha palët në procedurë, si ankuesi-

[redacted] autorizuar i saj [redacted] si dhe përf. i Ministrisë së Drejtësisë- Departamenti për profesionet e lira – Divizioni për noteri dhe përmbartues privat Fadilete Hoxhaj në cilësinë e iniciuesit të procedurës disiplinore.

Përf. i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë – Departamenti për profesione të lira- Divizioni për noteri dhe përmbartues privat Fadilete Hoxhaj, në fillim të seancës dëgjimore ka bërë shtjellimin e propozimit për fillimin e procedurës disiplinore ndaj [redacted] nga Prishtina, duke theksuar se mbetet pranë pretendimeve të theksuara me shkrim, se përmbartuesi [redacted] ka bërë shkelje disiplinore të paraparë me nenin 367 par. 1 të LPP-së, sepse i njejtë me rastin e ndërmarrjes së veprimeve përmbartimore sipas lëndës P.nr. 1346/18 me veprimet e tija ka bërë shkelje ligjore sepse ka tejkaluar autorizimet ligjore të tij.

Në seancën dëgjimore të mbajtur me dt. 25.09.2020 kryesuesi i komisionit disiplinor në fillim të seancës dëgjimore ja ka dhënë mundësin shkelësit disiplinor të pretenduar respektivisht përmbartuesit privat që të deklarohet lidhur me përgjegjësinë disiplinore për pranimin e përgjegjësisë në pajtim me nenin 7 par. 3 të UA-MD. Nr. 09/2014 të procedurës disiplinore me çrast përmbartuesi privat ka deklaruar se nuk e ndien veten përgjegjës për shkelje disiplinore të pretenduar.

[redacted] gjatë seancës dëgjimore në tërësi ka deklaruar se mbetet pranë deklarimeve të tija në përgjigjen e tij me shkrim të dt. 17.04.2020, duke shtuar se pretendimet e ankuesit të thëna në ankesën e saj të dt. 17.04.2020 janë të pa bazuara, se të njëjtat pretendime nuk qëndrojnë, nga se unë kam caktuar përmbartimin e lëndës së lartpërmendur sepse



e njejta i ka plotësuar të gjitha kushtet formale ligjore sepse aktvendimi ka qenë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm me dt. 05.10.2010. Pastaj të dyja instancat gjyqësore e kanë vërtetuar, kanë vendosur dhe e kanë vërtetuar urdhërine tim mbi lejimin e procedurës përmbartimore lidhur me rastin në fjalë. Lidhur me bllokimin e llogarisë së ankueses nuk kam vepruar në kundërshtim me ligjin sepse unë pa varësisht që është bërë i formës së prerë aktvendimi në fjalë më herët kur është vendosur për prapësimin me gjithë atë me kërkesë të këshillit gjyqësor mu është kërkuar që të presë edhe vendimin e shkallës së dytë përkitazi me çështjen në fjalë, dhe pas ardhës së vendimit të shkallës së dytë i cili është vërtetuar me dt. 08.10.2018 sipas ligjit kam bllokuar llogarinë e ankuesit në këtë rast. Deklaroj se nuk kam ndërmarrë asnjë vendim të kundërligjshëm, nuk kam bërë shkelje të procedurës, përkundrazi deklaroj edhe një herë se të gjitha aktvendimet e marra lidhur me këtë çështje janë vërtetuar nga gjykata. Sa i përket pretendimeve të palës ankuese lidhur me bazën ligjore të kërkesës të parashtruar nga ana e palës në fjalë, përkitazi me kërkesën (vendimin) ajo le të kërkojë –në të inicoj procedurë në këshillin gjyqësor dhe të prish vendimin i cili është dokument i ekzekutueshëm, dhe pas gjithë kësaj deklaroj se nuk e ndien veten përgjegjës.

Ankuesja \_\_\_\_\_ ga Prishtina, - i autorizuari i saj \_\_\_\_\_ gjatë seancës dëgjimore disiplinore kanë theksuar se në tërësi ngelin si në të dhënat në kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore, dhe duke shtuar gjatë seancës dëgjimore edhe një herë se organi përmbartues – \_\_\_\_\_ me veprimet e tia përkitazi me përmbartimin e çështjes përmbartimore sipas lëndës P.nr. 1346/18 ka shkelur ligjin e procedurës së përmbartimit dhe ka tejkaluar autorizimet e tia ligjore me çrrastë në mënyrë të kundërligjshme ka lëshuar urdhrin për përmbartim i cili nuk ka qenë i plotfuqishëm dhe as i ekzekutueshëm, pastaj ka bërë edhe bllokimin e xhirrollogarisë bankare të ankueses në këtë rast të dëmtuarës


mënyrë të pa drejtë-të kundërligjshme. Se ky propozim ka përmbajtur vetëm vulën e protokollit të përmbartuesit i cili bazohet në aktvendimin nr. 09/106, respektivisht Nr.i Ref. 1/2018 të dt. 25.09.2018, me të cilin është anuluar pjesërisht ujdia jashtë-gjyqësore e jo ndonjë ujdi administrative siç pretendohet. Deklarojmë edhe një herë se ky aktvendim nuk ka qenë i formës së prerë dhe as i ekzekutueshëm me dt. 05.10.2018. siç pretendon përmbartuesi dhe bazuar në të gjitha këto që janë thënë në ankesën e parashtruar si dhe në deklaratimet gjatë seancës së sotme dëgjimore kërkojmë nga komisioni disiplinor që ndaj të njëjtit të bëjë vendim për shqiptim të masës disiplinore dhe atë shkarkim nga detyra e përmbartuesit privat.

Komisioni disiplinor pas përfundimit të seancës dëgjimore, të të gjitha palëve në procedurë, si dhe pas administrimit të provave dhe shqyrtimit të njëjtave, veç e veç dhe të gjithave së bashku si dhe provave tjera të parashtruara me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje. Ka ardhur në përfundim se gjendja faktike e përshkruar në dispozitiv të këtij vendimi është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të saktë, dhe se i \_\_\_\_\_ me rastin e përmbartimit të çështjes përmbartuese të lartpërmendur, nuk ka bërë shkelje disiplinore me rastin e zbatimit të LPP-së, dhe atë nga neni 367 par. 1, si dhe as që ka bërë tejkalim të autorizimeve ligjore lidhur me çështjen në fjalë- çështjes përmbartimore P.nr. 1346/18, nuk është gjetur se ka kryer shkelje disiplinore në këtë çështje përmbartimore për shkak se gjatë ndërmarrjes së veprimeve përmbartimore i është përmbajtur dhe i ka zbatuar drejtë dispozitat e ligjit të procedurës përmbartimore.

Andaj më sa u tha më lartë e duke vepruar në pajtueshmëri me dispozitat e nenit 4 dhe 7 të Udhëzimit Administrativ- MD.nr. 09/2014, dhe nenit 374 par. 1 të LPP-së, komisioni disiplinor ka vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT**  
DPL. nr.10/2020 të dt. 25.09.2020

**Kryetari i Komisionit Disiplinor**  
**Xhemil Elshani**



**KËSHILLI JURIDIK** : Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të hap konflikt administrativ bazuar sipas nenit 374 par. 5 të LPP-së.